

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo		
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo		
CAA		
Nr. i prot.	2023/ZDP/373	
Br. prot./Prot.Nr.		
Faqe: 2	Kopje: -	Datë: 31/10/2023
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date
Hyrës/ulazno/in	<input type="checkbox"/>	
Dalës/fizlazo/out	<input checked="" type="checkbox"/>	
Brendshëm/interno/intemal	<input type="checkbox"/>	
Prishtinë/Prishtina/Pristina		

10/ZDP/VE/2023
Datë: 31 tetor 2023

Në mbështetje të nenit 15.1 (d) dhe (j), 37 dhe 39.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt. 1 mars 2019), në pajtim me Shtojcën II, Nën-pjesën D, piken ATCO.AR.D.005 të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrolloreve të trafikut ajror,

Duke marrë për bazë rekomandimin e Departamentit të Shërbimit të Navigacionit Ajror, dt. 30 tetor 2023, me nr. prot. 2023/SHNA/367, lidhur me shfuqizimin e masës së pezullimit të gradimeve APP të kontrollorit të trafikut ajror me nr. CAA001,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

V E N D I M

- SHFUQIZOHET masa e pezullimit të gradimeve APP, e vendosur përmes Vendimit 04/ZDP/VE/2023 i dt. 07 qershor 2023, për Kontrollorin e trafikut ajror me nr. të licencës nr. CAA001.
- Kontrollorit të trafikut ajror nga pika 1 e këtij Vendimi, i kthehen gradimet APP, respektivisht miratimet APP dhe APS.
- OBLIGOHET Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror në përputhje me legjislacionin në fuqi të marrë të gjitha masat e nevojshme lidhur me zbatimin e këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Si rrjedhojë e incidentit të datës 24 shkurt 2023 TCAS RA, përmes Vendimi 04/ZDP/VE/2023, AAC ka vendosur të pezulloj gradimet APP për kontrollorin e trafikut ajror me numër të licencës CAA001, me ç'rast pas hetimit përveç tjerash, ka rezultuar me nevojën e ri trajnimit për kontrollorin në fjalë.

Me datë 29 gusht 2023, Departamenti i SHNA-së ka pranuar e-mailin nga Zv. Menaxheri i DATS nga ASHNA, përmes të cilit AAC është njoftuar se kanë përgatitur planin e ri-trajnimit për kontrollorin me numër të licence CAA001, i cili plan është konsideruar i pranueshëm nga AAC.

Me datë 20 tetor 2023, ASHNA ka njoftuar se ashtu siç ka qenë e parashikuar, Kontrollori me numër të licencës CAA001 ka përfunduar me sukses të gjitha kërkesat e parapara ne Planin e ri trajnimit për sa i përket trajnimit në pune (OJT) si dhe është vlerësuar nga OJTI për së paku 40 orë efektive pune për miratimin APS dhe 12 ore efektive pune për miratimin APP, ashtu siç përcaktohet në pikën 5.2 të planit të ri trajnimit paragrafi 3.

Me datë 27 tetor 2023, ASHNA përmes e-mailit ka njoftuar se në datat 26-27 tetor 2023 është mbajtur vlerësimi i kompetencës në detyrë për Kontrollorin me numër të licencës CAA001, me ç'rast ka rezultuar se i kontrollori në fjalë I përbush kriteret për rimarrjen e gradimeve APP respektivisht miratimeve APS dhe APP. Në këtë e-maili janë bashkangjitur edhe dokumentet relevante.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve dhe sqarimeve të dhëna, Departamenti i SHNA-së ka vërejtur se janë realizuar objektivat e planit të ri të trajnimit si dhe janë plotësuar hapat e paraparë në UPT për këtë rast dhe si rrjedhojë ka rekomanduar kthimin e gradimeve APP, respektivisht miratimet APP dhe APS për kontrollorin e trafikut ajror me nr. të licencës CAA 001.

Nga sa u tha me lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenet 15.1 (d) dhe (j), 37 dhe 39.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të agjencive të pavarura, me Shtojcën II, piken ATCO.AR.D.005 të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, dhe rekomandimit të Departamentit të SHNA-së, ka vendosur si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të ngrit kontest administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

